



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 190

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 42 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Mariglen Disha**
Kryetar i Bashkisë Librazhd

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nëpërmjet hapjes së programit “Kredia e butë” nga Bashkia Librazhd.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 42 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Librazhd ka miratuar programin “Kredia e Butë”, lajm i cili është njoftuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, Mariglen Disha më datë 10.01.2025 ora 10:00, në rrjetin e tij social Facebook. Sipas këtij postimi Bashkia Librazhd synon mbështetje e familjeve për përmirësimin e kushteve të strehimit.

Data 25.02.2025

Nr: 190
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 42 ID, datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

Për sa më sipër vlerësojmë se hapja e këtij programi para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje të nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregulltar, pasi ka sfond propagandistik dhe lidhjet me zgjedhjet për kuvend të datë 11 Maj, 2025 dhe manipulimin e votuesëve”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mos fillimin e procedurës administrative të denoncimit nr. 42, datë 24.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI